

**FJALA E POPULLIT**

# POPULLI VENDOS PËR TË ARDHMEN E VET

TRINGA (12), HARIS (12), ALBION (12), ARTAN (11), ZGJIM (11), RUDINA (11)

## KUVENDI I ZBATON PARIMET E DEMOKRACISË



### Nga ne do të mësoni se pse demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes

Të shprehësh mendimin tënd lirshëm, do të thotë të jetosh në një shtet demokratik. Demokracia përfshin elemente shumë të mira dhe nëse zbatohen elementet e saj, i gjithë vendi do të funksionojë shumë mirë. Sigurisht jeni të interesuar të dini se cilat janë disa nga elementet e demokracisë që duhet të zbatohen nga të gjithë ne. Këto elemente të demokracisë janë: të drejtat e barabarta, liria, paqja, toleranca, barazia, shprehja e lirë e mendimit etj. Demokracia për herë të parë është shfaqur në Athinë të Greqisë në vitin 507 para erës sonë. Edhe pse atëherë nuk ka qenë demokraci e plotë, ne jemi shumë të lumtur që demokracia ka filluar atëherë dhe tash të gjitha shtetet që i zbatojnë elementet e saj kanë mundësinë të jetojnë të lumtur dhe në paqe.

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“ që do

të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje. Kjo nënkupton se populli qeveris me vendin. Janë dy lloje të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Në demokracinë e drejtpërdrejtë populli i merr vendimet aty për aty, kurse në demokracinë përfaqësuese, populli i zgjedh përfaqësuesit me anë të votës. Por, demokracia përfaqësuese i ka edhe dy sisteme të veta të cilat janë: demokracia përfaqësuese parlamentare dhe ajo presidenciale. Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare dhe ne jemi shumë të lumtur për këtë fakt, sepse deputetët që populli i zgjedh i përfaqësojnë interesat e popullit. Por, gjithmonë duhet pasur parasysh se populli duhet të kontribuoj vazhdimisht në përforsimin dhe në zbatimin e elementeve të demokracisë, sepse kështu do të kemi një të ardhme edhe më të ndritur. Të gjithë së bashku mund ta bëjmë më të mirën për shtetin tonë demokratik.



Demokracia, sistemi më i mirë i qeverisjes




Gazetarët e demokracisë



Në këtë vizatim është paraqitur një qytetar i përgjegjshëm duke votuar



Kuvendi, vendi ku miratohen ose nuk miratohen ligjet



Ne jemi e ardhmja e vendit. Ndryshimi vjen nga ne, prandaj duhet të punojmë për të mirën e tij



Ky është një vizatim i demokracisë në vendin tonë

## SHTËPIA E POPULLIT

AULON (11), ALTIN (12), ARDONITA (12), DENIS (11), ELËSA (11), GRESA (12), RINESA (11)



### Kuvendi është institucioni më demokratik dhe ligjvënës në Republikën e Kosovës

Vendet demokratike kanë edhe udhëheqje demokratike, sepse udhëheqësit janë të zgjedhur direkt nga populli. Këta udhëheqës, punojnë nëpër institucione të ndryshme të cilat po ashtu janë të udhëhequra në mënyrë demokratike. Por, cilat janë këto institucione ku punojnë të zgjedhurit e popullit do të informoheni gjatë artikullit.

Kuvendi i Kosovës është një ndër këto institucione ku populli i zgjedh përfaqësuesit e vet me anë të votave, të cilat janë të lira, të drejtpërdrejta dhe të fshehta. Këta përfaqësues ndryshe quhen deputetë, mandati i të cilëve është katër vjeçar. Përpos Kuvendit, edhe Komuna është e udhëhequr nga të zgjedhurit e popullit të cilët janë asambleistët dhe kryetari i komunës, të cilët po ashtu kanë mandat katër vjeçar.


Pasi që si temë diskutimi kishim Kuvendin, ne, do t'iu

informojmë më shumë rreth funksioneve të tij. Kuvendi i Kosovës përbëhet nga 120 deputetë, të cilët janë të zgjedhur direkt nga populli. Për këtë arsye një ndër funksionet kryesore që ka Kuvendi është përfaqësimi i popullit.

Nga ky numër i madh i deputetëve kemi edhe parti të ndryshme, dhe gjithashtu kemi edhe deputetë nga etnicitete të ndryshme. 100 nga deputetët janë të kombit shqiptar, ndërsa 20 prej tyre janë të komuniteteve jo shumicë të Kosovës. Pra, Kuvendi na qenka një institucion multi etnik dhe shumë partiak.

Më lart cekëm një ndër funksionet e Kuvendit i cili ishte përfaqësimi i popullit. Përpos këtij funksioni, Kuvendi ka edhe disa funksione të tjera si: miratimin (mos miratimin) e ligjeve, mbikëqyrjen e Qeverisë, miratimin e buxhetit të Kosovës, zgjedhjen e Presidentit, etj.

Nga kjo kuptuam se Kuvendi ka një rëndësi shumë të madhe si institucion.



Disa qytetarë duke votuar për përfaqësuesit e tyre



Autorët e artikullit

# PROCESI ZGJEDHOR NË NJË VEND DEMOKRATIK

BLERTA (12), EDIONA (11), HAJRULLA (11), ANDREA (12), EDUARD (11), EDONITA (12), ELVISI (11)

## Në këtë artikull ju mund të lexoni për zgjedhjet në demokraci

Liri, fjalë që shqiptohet lehtë por që ka kuptim të madh. Gjithmonë kemi parë raste ku njerëzit kanë kërkuar që mendimet e tyre t'i shprehin sa më lirshëm dhe të mos jenë të cënuara nga askush. Këtë na e mundëson demokracia. Ne gjithashtu jemi të lirë të zgjedhim diçka që neve na pëlqen. Mirëpo, që të marrim pjesë në një proces zgjedhor që zhvillohet në një vend demokratik ne duhet të jemi mbi 18 vjet, pasi që atëherë ne jemi më të vetëdijshëm për veprimet tona.

Kemi dy lloje zgjedhjesh, ato janë: zgjedhjet lokale (komunale) dhe zgjedhjet qendrore (parlamentare). Në zgjedhjet lokale populli voton për kryetarin e komunës dhe asambleistët, ndërsa në zgjedhjet qendrore populli voton përfaqësuesit e tyre, dhe ata përfaqë-

sues ndryshe njihen edhe si deputetë.

Në një vend demokratik me sistem parlamentar, brenda Kuvendit deputetët zgjedhin me anë të votave Presidentin e vendit.


Rëndësia e votave dhe procesit zgjedhor është shumë e madhe, sepse përmes tyre qytetarët zgjedhin personat që do t'i përfaqësojnë ata në të ardhmen.

Votimet mund të jenë të hapura dhe të mbyllura. Në procesin zgjedhor kur votohen deputetët, bëhet me votim të mbyllur për shkak që të mos ketë manipulime me votat e qytetarëve.

Shpresojmë që ky artikull ju ka pëlqyer dhe keni kuptuar se sa e rëndësishme është vota, dhe se si zhvillohet një proces zgjedhor në një vend demokratik.



Kandidati për deputet duke folur para qytetarëve të tij



Udhëheqja e popullit



Vota është shumë e rëndësishme në demokraci



Grupi i gazetarëve



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Zenel Hajdini“  
Klasa: VI-1  
Vendi: Prishtinë